

KUMTESE

Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës njofton opinionin publik se, në kuadër të analizës së kushteve dhe regjimit për shfrytëzimin e zonës „Hug & Fly“ në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, nga TAV Maqedoni janë kërkuar sqarime shtesë dhe të dhëna relevante lidhur me kufizimin e vendosur për qasjen pa pagesë.

Pas kërkesës së parashtruar, TAV Maqedoni e ka njoftuar Komisionin se ka tërhequr vendimin përmes të cilit qasja pa pagesë për një automjet kufizohet në vetëm një hyrje brenda një periudhe 24-orëshe.

Komisioni e përshëndet vendimin e TAV Maqedoni për tërheqjen e masës dhe do të vazhdojë të monitorojë gjendjen dhe kushtet e qasjes në infrastrukturën e aeroportit, veçanërisht në aspektin e sigurimit të kushteve të barabarta dhe jodiskriminuese për të gjithë pjesëmarrësit në treg.

Komisioni mbetet i përkushtuar në mbrojtjen e konkurrencës dhe do të vazhdojë të veprojë në kuadër të kompetencave të tij ligjore, sa herë që ekziston mundësia që kushte ose masa të caktuara të kenë ndikim në konkurrencën dhe interesat e qytetarëve.